



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Bordi

VENDIM

Nr. 121, Datë 22.07.2019

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “SPAHIU GJANÇ” SH.P.K PËR DHËNIEN E
AUTORIZIMIT NGA ANA E ERE-S, PËR NDRYSHIMIN E ORTAKËVE TË
SHOQËRISË “SPAHIU GJANÇ”, NËPËRMJET SHITJES SË 100% TË KUOTAVE
TË KAPITALIT, TEK SHOQËRIA “HYDRO INVEST” SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, pikës 5.2 të “Licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike” miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.06.2016 dhe pikës 6.2 të “Licencës së veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.06.2016, si dhe nenit 15 të “Rregullave për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.07.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve dhe Mbikqyrjes mbi kërkesën e shoqërisë “Spahiu Gjanç” shpk, për dhënien e autorizimit nga ana e ERE-s, për ndryshimin e ortakëve të shoqërisë “Spahiu Gjanç” shpk, nëpërmjet shitjes së 100% të kuotave të kapitalit,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Spahiu Gjanç” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 416, datë 21.06.2019, ka përcjellë kërkesën për dhënien e autorizimit nga ana e ERE-s, në lidhje ndryshimin e ortakëve të shoqërisë, përmes shitjes së 100% të kuotave me vullnetin e saj të lirë tek shoqëria “HYDRO INVEST” shpk.
- ERE me shkresën nr. 416/1 Prot, datë 03.07.2019 iu drejtua shoqërisë “Spahiu Gjanç” shpk, duke i kërkuar të plotësojë dokumentacionin e munguar për shqyrtimin e kësaj kërkesë e që konsistonte në:
 - Vendimin e Asamblesë së Përgjithëshme për shitjen e 100% të aksioneve.
 - Miratimin e dhënë nga MIE për shitjen e 100% të aksioneve.
 - Dokumentacionin e shoqërisë blerëse të aksioneve “HYDRO INVEST” shpk, si Aktin e themelimit; Statutin; Çertifikatën e regjistrimit në QKB.
- Shoqëria “Spahiu Gjanç” shpk, në përgjigje të sa më sipër, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 416/2, datë 08.07.2019, plotësoi sa kërkuar.
- Shoqëria “Spahiu Gjanç” shpk, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar më 23.09.2003 dhe regjistruar pranë QKB në datën 15.01.2004, me ortakë z. Dalip Spahiu dhe z. Faik Bruçi, zotërues respektivisht nga 50 % të kuotave të kapitalit dhe është mbajtëse e Licencës nr. 11, Seria PV03K, së miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 20, datë 19.12.2003, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike

nga HEC “Gjanç” me kapacitet të instaluar 3.7 MW, për një afat 30 vjeçar; Licencës nr. 224, Seria T14P, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 14, datë 03.03.2014, së veprimtarisë të tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 20 vjeçar.

- Shoqëria “HYDRO INVEST” shpk, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar në QKB në datën 27.05.2019, me objekt veprimtarie, zhvillimin e impianteve për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, menaxhimin dhe drejtimin e tyre si dhe shitjen e energjisë etj, ka ortak të vetëm shoqërinë italiane LUMI SR, e cila është një shoqëri e regjistruar pranë regjistrit të biznesit në Genova, me nr. 02612700993, numër REA GE- 498970, datë 16.05.2019, zotëruese të 100 % të aksioneve të shoqërisë “HYDRO INVEST” shpk.
- Vendimi i datës 05.07.2019, i Asamblesë së Përgjithëshme të shoqërisë “Spahiu Gjanç” shpk, ka miratuar me unanimitet shitjen e 100% te kapitalit themeltar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar të së drejtës shqiptare “Spahiu Gjanç” shpk, me NUIS: K413160030, me seli në Korçë, Mollaj Gjanç, Godine 1-kateshe, përballë N/stacionit 35 Kwh, nga ortakët e saj Dalip Spahiu dhe Faik Bruçi, (Shitësit) në favor të shoqërisë së të drejtës Shqiptare Hydro Invest sh.p.k, me NUIS L91727018T, me seli, Njësia Bashkiake Nr. 5, Rruga Emin Duraku, Pallati Binjaket Nr. 5, Tiranë, Shqiperi (Bleresi);
- Pas ndryshimit të ortakëve nëpërmjet shitjes së kuotave, shoqëria “HYDRO INVEST” shpk, mbetet ortak i vetëm i 100% të kuotave të shoqërisë koncesionare “Spahiu Gjanç” shpk.
- Shoqëria Koncesionare “Spahiu Gjanç” shpk, do të vazhdojë të jetë subjekti i vetëm mbajtës i licencës së lëshuar nga ERE dhe i gjithë aseteve të hidrocentralit Gjanç, sipas Kontratës së Koncesionit deri në përfundimin e saj.
- Shoqëria “Spahiu Gjanç” shpk, ka kryer pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Dhënie e autorizimit nga ana e ERE-s, për ndryshimin e ortakëve të shoqërisë “Spahiu Gjanç” shpk, nëpërmjet shitjes së 100% të kuotave të kapitalit, tek shoqëria “HYDRO INVEST” shpk.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve dhe Mbikqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.
- 3.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brënda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

PETRIT AHMETI